



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



EKONOMIA DHE BUXHETI

SHKURT, 2008

Raporti Mujor

Shkurt, 2008

Personi i kontaktit: Skënder UKU
Telefon: ++355 (4) 222 920
e-mail: generalmacro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE	1
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	2
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	2
2. Kursi mesatar i këmbimit	3
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	4
4. Bilanci i Pagesave	5
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	6
6. Kredia për Ekonominë	6
7. Oferta e Parasë	7
8. Depozitat sipas Burimeve	9
SEKTORI FISKAL	10
1. Buxheti i Konsoliduar	10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	11
3. Financimi i Sufiçitit	11
APENDIKSI STATISTIKOR	12


VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Shkurt, 2008 arriti në 101.5 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Shkurt ishte 3.6 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Shkurt 2008 ishte 83.90 lekë për dollarë dhe 123.69 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Shkurt shënuan kuotat 6.69 përqind për depozitat 24 mujore, 6.10 për ato 12 mujore, 5.44 për 6 mujorët dhe 4.80 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 11.78 përqind për huatë 12 mujore dhe 14.29 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 765 miliardë lekë në muajin Shkurt, duke shënuar një rritje prej rreth 12 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave* për vitin 2007 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 148.6 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Dhjetor 2007 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 34 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara në Janar – Dhjetor 2007 arritën në rreth 255.5 miliardë lekë ose rreth 95.8 përqind e planit vjetor 2007
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 285.7 miliardë lekë ose rreth 93.7 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2007

ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Shkurt 2007 pësoi një rritje prej 1.0 përqind krahasuar me muajin Janar dhe Dhjetor 2007, kur ky indeks shënonte përkatësisht 0.5 përqind dhe 1.2 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 0.5 përqind, 0.5 përqind dhe 1.3 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Shkurt u konstatua në grupin “Ushqime dhe pije joalkolike” 2.6



Ndryshimet mujore të IÇK-së

Burimi: INSTAT

Gjatë këtij muaji rritje shënoi edhe indeksi i çimeve të grupit “Transporti” me rreth 0.3 përqind, si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të nëngrupit “Shërbime transporti” me 1.0 përqind.

Uljen më të madhe, prej 0.6 përqind këtë muaj e pësoi indeksi i çmimeve të grupit “Veshje dhe këpucë”.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2.0
2008	3.0	3.6				
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2007	2.1	4.2	4.4	4.2	3.5	3.1
2008						

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Shkurt arriti në 3.6 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2007 dhe 2008 paraqiten në tabelën 1.

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Shkurt 2008, arriti në 123.69 Lekë/Euro, duke shënuar një rritje prej 0.9 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Shkurt një euro u këmbye me 125.34 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Shkurt 2008, arriti në 83.90 lekë/dollarë duke shënuar një ritje të lehtë kundrejt muajit Janar. Në fund të muajit Shkurt, dollari amerikan arriti nivelin 82.58 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Shkurt



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë Shkurt


në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 1.474 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë muajit Dhjetor përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitetet e politikës fiskale, efikasitetet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, rritjen e flukseve hyrëse në valutë etj.


të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 12.4 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 1.2 përqind. Mbicmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Shkurt 2008, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 6.10 përqind, duke pësuar një rënie prej 0.39 përqind në krahasim me muajin




Janar, ku normat e interesit shënonin vlerën 6.49 përqind. Rënie për këtë muaj kanë pësuar si depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.12 përqind, normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor me 0.28 përqind, ashtu dhe normat e depozitave me afat 1 - mujor me 0.11 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar normat e interesit të depozitave me afat 12, 6 dhe 3 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Shkurt pësoi një rënie 1.58 pikë përqind, duke arritur në 11.78 përqind nga 13.36 përqind që ishte në muajin Janar. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësoi një rritje me 1.24 pikë përqind, krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave



6-mujore për muajin Shkurt arriti në 14.29 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Shkurt 2008, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 8.00 përqind, 7.29 përqind dhe 6.26 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 6 mujor.


4. Bilanci i Pagesave



Bilanci i Pagesave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar - Dhjetor 2007 regjistroi një sufit të përgjithshëm prej 148.6 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.



Llogaria Korente

Burimi: Banka e Shqipërisë


Kompozicioni i deficitit të llogarisë korente prej 831.6 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'07 - dhjetor'07 rezultoi:

(i) bilanci tregtar -2,104 mln euro, (ii) shërbime neto 12.8 mln euro, (iii) të ardhura neto 216.8 mln euro, (iv) transferta neto 1,042.8 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në

grafikun 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Shkurt 2008, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 325 milionë dollarë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e



Shqipërisë me rreth 369.8 milionë dollarë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 44.8 milionë dollarë. Në muajin Shkurt sistemi bankar rezulton me një rënie prej 63.6 milionë dollarë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Janar, rënie e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve

valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 94.7 milionë dollarë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 31.1 milionë dollarë.

6. Kredia për Ekonominë


Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Shkurt 2008 arriti në 301.9 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me një vit më parë shënoi vlerën 98.4 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 48.4 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në vitin 2007.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 73.1 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 220.8 miliardë lekë.


Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 36.2 përqind.

7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Shkurt ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Janar. Kjo ofertë arriti në rreth 765 miliardë lekë në fund të muajit Shkurt duke shënuar një rritje prej 3.9 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në




muajin Dhjetor 2007. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 12 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 3 përqind, rritjes së depozitave në valutë me rreth 28 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 12 përqind dhe rënies të parasë jashtë sistemit me rreth 5 përqind.



Ndikimin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit Shkurt e kanë patur rritja e depozitave me afat në lekë, të cilat vetëm gjatë këtij muaji u rritën me rreth 3.6 miliardë lekë si dhe rritjes së depozitave në valutë me 4.1 miliardë lekë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit Shkurt arriti në 19.2 përqind duke shënuar një rënie të lehtë në krahasim me muajin Janar. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Shkurt arriti në rreth 23.8 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.1 përqind e krahasuar me muajin Janar.

Graf - 10




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 1.4 miliardë lekë në krahasim me muajin Janar. Rritje prej rreth 4.1 miliardë lekë në krahasim me muajin Janar, pësuan depozitat në valutë. Norma vjetore e rritjes së tyre në fund të muajit Janar arriti në 28 përqind, duke pësuar një renie në krahasim me muajin paraardhës.

Graf - 11



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Shkurt, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 75.5 përqind të depozitave totale në valutë.

8. Depozitat sipas Burimeve


Gjatë muajit Shkurt 2008 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 50.31 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 37.77 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jofinanciare, me 9.96 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 75.5 përqind dhe rreth 20.4 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i

rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (95.9 përqind e totalit)

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 502 miliarde) të depozitave totale, prej rreth 618 miliardë lekë në muajin Janar 2008. Ata ndiqen nga sektori privat (92 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (17.5 miliardë) dhe autoritetet lokale (3.5 miliardë). Institucionet financiare kontribuan me rreth 2.3

miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit Shkurt 2008, krahasuar me një muaj më parë Janar, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 2.6 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe të atyre në valutë .

Graf - 12




Përberja e depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhen Janar - DHjetor, janë mbledhur rreth 251.6 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 285.7 miliardë lekë, që përfshijnë 224.9 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 57 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 84.5 % financim i brendshëm, dhe 15.5 % financim i huaj.



Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 95.8 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2007, ndërsa shpenzimet përbëjnë 93.7 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 96.2 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 83.7 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 176.8 miliardë lekë (ose rreth 98.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura

nga pushteti vendor 9.4 miliarde lekë (70.2 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 41.9 miliarde lekë (101.4 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 22 miliardë lekë (92.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 224.9 miliarde lekë, 59 miliardë lekë (26.6 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 25.6 miliardë lekë (11.4 %) për interesat, 25.2 miliardë lekë (11.2 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 3.5 miliardë lekë (1.6 %) për subvencione, 69.9 miliardë lekë (31.1 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 21.3 miliardë lekë (9.5 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 14.8 miliardë lekë (6.6 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 96.7 % (shpenzime personeli), 99 % (shpenzime për interesat), 96.4% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 99 % (subvencione), 97.7 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 79 % dhe 98 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 93.4 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 52 %.

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Dhjetor 2007 ishin rreth 251.6 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 228.2 miliardë, grantet 1.3 miliardë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 22 miliardë.

Tab - 2 Të ardhurat e realizuara në Janar – Dhjetor 2007

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	87.8
Tatimi mbi fitimin	21.1
Taksa doganore	9.9
Taksat nacionale	14.5
Akcizat	28.7
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	5

3. Financimi i Suficitit

Deficiti prej 34.1 miliardë lekë, për periudhën Janar-Dhjetor, u mbeshtet në vlerën 28.8 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 5.3 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Dhjetor disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 24.6 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 63.4 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 16.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 35.5 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 24.2 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit
Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)								Mesatar Mujor (Monthly Average)								Vjetor (Annual)								Month
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	
Janar	-1.3	1.5	-0.2	-0.2	0.8	0.2	0.5	0.5	-1.3	1.5	-0.2	-0.20	0.80	0.20	0.50	0.50	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4	2.9	3.0	January
Shkurt	-1.3	-0.3	0.9	1.9	0.4	0.4	0.5	1.0	-1.30	0.62	0.35	0.85	0.60	0.30	0.50	0.75	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3	2.9	3.6	February
Mars	0.3	0.2	0.4	0.1	0.0	0.1	-0.1		-0.77	0.47	0.37	0.60	0.40	0.23	0.30		2.9	7.5	1.4	4.0	1.6	1.5	2.7		March
Prill	0.8	-0.1	0.8	0.0	-0.3	0.6	-0.2		-0.38	0.33	0.48	0.45	0.23	0.33	0.18		3.0	6.5	2.3	3.2	1.3	2.4	1.9		April
Maj	0.2	-1.6	-1.1	-1.7	-1.1	-0.4	-0.8		-0.26	-0.06	0.16	0.02	-0.04	0.18	-0.02		2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1	1.4		May
Qershor	-0.7	-1.5	-1.7	-1.4	-0.5	-1.1	-0.6		-0.33	-0.30	-0.15	-0.22	-0.12	-0.03	-0.12		4.0	3.7	2.6	2.9	2.9	2.4	2.0		June
Korik	-1.2	-0.7	-0.4	-0.2	-1.2	-0.4	-0.3		-0.46	-0.36	-0.19	-0.21	-0.27	-0.09	-0.14		5.6	4.2	2.9	3.1	1.8	3.2	2.1		July
Gusht	-1.0	0.2	0.2	-0.2	0.2	-0.2	1.9		-0.53	-0.29	-0.14	-0.21	-0.21	-0.10	0.11		4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	2.8	4.2		August
Shtator	1.1	0.9	0.7	0.1	0.9	0.6	0.9		-0.34	-0.16	-0.04	-0.18	-0.09	-0.02	0.20		3.5	5.3	2.8	2.0	3.1	2.6	4.4		September
Tetor	-0.4	0.1	0.2	0.2	0.4	0.1	-0.1		-0.35	-0.13	-0.02	-0.14	-0.04	-0.01	0.17		1.8	5.8	2.9	2.0	3.3	2.2	4.2		October
Nendor	1.9	-0.1	0.4	0.5	0.2	0.9	0.2		-0.15	-0.13	0.02	-0.09	-0.02	0.07	0.17		2.8	3.7	3.4	2.2	3.0	2.9	3.5		November
Dhjetor	5.3	3.2	3.1	3.1	2.2	1.8	1.3		0.31	0.15	0.28	0.18	0.10	0.22	0.27		3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	3.1		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source: INSTAT, Bank of Albania

Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008		Currency
									Jan	Feb	
<i>edhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)</i>											
<i>Mesatarja e periudhes</i>											<i>Average of period</i>
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	90.43	83.39	83.90	USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	123.63	122.61	123.69	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>											<i>In the end of period</i>
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	82.89	82.61	82.58	USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	121.78	122.61	125.34	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3 **Normat e interesit me baze vjetore**
 Annual Interest Rates

2008				
Ne perqindje Fundi I periudhes	Dhjetor 07 Dec	Janar Jan	Shkurt Feb	In percent End of period
Norma e remunerimit				Remuneration rate
ne leke	-	4.37	4.37	In Lek
ne usd	-	2.30	2.19	In USD
ne euro	-	2.92	2.93	in EURO
Norma e depozitave				Deposits rates
12-M	6.33	6.49	6.10	12-M
6-M	5.50	5.56	5.44	6-M
3-M	4.85	5.08	4.80	3-M
1-M	3.21	3.59	3.48	1-M
Norma e huase				Lending rates
12-M	13.55	13.36	11.78	12-M
6-M	13.85	15.53	14.29	6-M
Norma e letrave me vlere				Securities rates
Bobo thesari 1/				Treasury bills 1/
3-M	6.48	6.20	6.26	3-M
6-M	7.51	7.30	7.29	6-M
12-M	8.41	8.14	8.00	12-M

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2007
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2007

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Nr.	E M E R T I M I	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	Tetor Oct	Nentor Nov	Dhjetor Dec	ITEM	No.
	TOTALI TE ARDHURAVE	18,783	35,375	55,326	74,812	93,235	115,536	134,864	156,376	181,931	205,457	226,963	251,631	TOTAL REVENUE	
I.	Ndihma	5	5	15	55	119	119	119	1,334	1,646	1,648	1,731	1,280	Grants	I.
II.	Te ardhura tatimore	17,267	32,765	50,829	69,232	87,083	105,525	123,949	143,595	164,193	185,839	205,903	227,972	Tax Revenue	II.
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	13,253	25,227	38,919	52,249	66,440	81,212	95,010	110,942	127,617	143,930	160,324	176,807	From tax offices and customs	II.1
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	7,104	12,908	19,690	26,421	33,602	40,669	47,693	55,341	63,304	71,727	80,084	87,771	V. A. T	1
2	Tatimi mbi Fitimin	1,394	2,918	5,361	6,920	8,698	10,555	11,930	13,755	15,212	16,758	18,917	21,077	Profit Tax	2
3	Akcozat	1,991	3,751	5,335	7,616	9,968	12,228	14,654	18,012	20,798	23,442	26,117	28,731	Excise Tax	3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	902	1,568	2,309	3,072	3,832	5,118	6,236	7,330	9,917	11,616	12,893	14,849	Personal Income Tax	4
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1,071	2,441	3,658	4,846	6,208	7,624	8,672	9,902	11,028	12,200	13,231	14,530	National Taxes and others	5
6	Taksa Doganore	791	1,642	2,566	3,375	4,132	5,018	5,826	6,602	7,358	8,187	9,081	9,848	Custom Duties	6
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	578	1,278	2,717	4,170	4,778	5,304	6,210	6,711	7,311	8,531	8,636	9,367	Revenues from Local Gov.	II.2
1	Taksa Lokale	491	1,155	2,334	3,534	4,025	4,486	5,110	5,545	6,084	6,855	6,518	7,135	Local Taxes	1
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	87	123	384	636	753	818	1,100	1,166	1,227	1,676	2,118	2,232	Small Business Tax	2
II.3	Te ardh. Buxh. Pavarur	3,436	6,260	9,194	12,812	15,865	19,009	22,729	25,942	29,265	33,378	36,943	41,798	Social Ins	II.3
1	Sigurimi Shoqeror	3,007	5,520	8,123	11,364	14,075	16,882	20,198	23,077	26,036	29,711	32,905	37,371	Social Insurance	1
2	Sigurimi Shendetesor	429	741	1,071	1,448	1,789	2,128	2,531	2,865	3,230	3,666	4,038	4,427	Health Insurance	2
III.	Te ardhura Jotatimore	1,511	2,604	4,482	5,526	6,034	9,892	10,796	11,447	16,092	17,970	19,329	22,379	Nontax Revenue	III.
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	1,010	1,010	1,010	1,010	1,010	1,010	3,010	3,010	3,010	5,010	Profit transfer from BOA	1
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	1,405	2,435	3,257	4,145	4,609	5,266	5,871	6,314	6,977	7,475	8,721	9,647	Income of budgetary institutions	2
4	Te tjera	106	169	215	371	415	3,615	4,123	4,123	6,104	7,485	7,598	7,722	Other/not allocated	4
	TOTALI I SHPENZIMEVE	12,254	30,693	48,925	67,450	86,498	105,385	125,925	148,358	171,725	196,430	222,253	285,671	TOTAL EXPENDITURE	
I.	Shpenzime Korrente	12,137	26,911	43,184	59,796	76,957	94,158	111,912	131,109	150,372	169,778	189,433	224,973	Current Expenditures	I.
I.1	Personell	3,731	7,767	12,148	16,612	21,058	25,589	30,463	34,923	40,080	45,310	50,922	59,088	Personnel expenditures	I.1
1	Paga	3,053	6,364	10,014	13,753	17,358	21,156	25,312	29,055	33,355	37,789	42,531	49,663	Wages	1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	678	1,402	2,134	2,859	3,700	4,433	5,151	5,867	6,735	7,522	8,390	9,425	Social insurance contributions	2
3	Politikat e reja pagash								0					Of which; Contingency	3
I.2	Interesat	2,209	3,687	5,942	7,963	10,067	12,055	14,642	16,900	18,406	20,319	22,966	25,591	Interest	I.2
1	Te Brendshme	2,117	3,443	5,628	7,383	9,368	11,029	13,541	15,655	17,087	19,001	21,255	23,495	Domestic	1
2	Te Huaja	92	244	314	580	699	1,026	1,101	1,245	1,318	1,318	1,711	2,096	Foreign	2
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	242	2,121	3,711	5,780	7,857	9,790	11,477	12,746	15,097	17,183	19,525	25,259	Operational & Maintenance	I.3
I.4	Subvencionet	45	159	633	745	926	1,270	1,455	1,539	1,766	1,900	2,094	3,536	Subsidies	I.4
I.5	dhe te tjera	4,784	8,996	15,279	20,919	26,555	32,346	38,208	44,431	50,581	56,390	62,066	69,892	Social insurance outlays	I.5
1	Sigurime Shoqerore	4,418	8,992	13,671	18,509	23,370	28,490	33,550	39,072	44,515	49,611	54,444	60,824	Social insurance	1
2	Sigurime Shendetesore	365	905	1,608	2,409	3,185	3,856	4,658	5,360	6,066	6,769	7,623	9,068	Health insurance	2
I.7	Shpenzime per Buxhetin Lokal	735	1,866	3,196	4,523	6,253	7,909	9,396	10,840	12,508	14,503	16,653	21,339	Local Budget	I.7
I.8	Shpenzime te tjera	391	1,415	2,275	3,254	4,242	5,199	6,271	7,230	8,175	9,182	10,207	14,768	Other expenditures	I.8
1	Pagesa e Papunesise	66	147	225	295	366	436	515	580	656	724	774	869	Unemployment insurance benefits	1
2	Ndihma Ekonomike	325	1,268	2,050	2,959	3,876	4,763	5,756	6,650	7,519	8,459	9,434	13,491	Social assistance	2
3	Kompensim per ish te perndjekurit politike													Compensation for ex political prisoners	3
I.9	Kompensim ne vlerë i pronareve												408	Property Compensation	I.9
II.	Fondi Rezerve												500	Reserve fund/contingency	II.
III.	Shpenzime Kapitale	117	3,782	5,741	7,654	9,541	11,227	14,013	17,250	21,353	26,652	32,820	57,040	Capital expenditures	III.
1	Financimi Brendshem	6	3,552	4,982	6,106	7,431	8,717	11,204	12,552	15,821	20,645	26,170	48,220	Domestically financing	1
2	Financimi Huaj	111	229	759	1,548	2,110	2,510	2,809	4,698	5,532	6,007	6,650	8,819	Foreign financed	2
IV.	Transferte KESH												3,000	KESH Transfer	IV.
V.	Transferte Kapitale												658	Capital Transfer	V.
	DEFIÇITI	6,529	4,682	6,401	7,362	6,738	10,150	8,940	8,018	10,205	9,027	4,710	-34,040	Overall Deficit	
	FINANCIMI DEFIÇITIT	-6,529	-4,682	-6,401	-7,362	-6,738	-10,150	-8,940	-8,018	-10,205	-9,027	-4,710	34,040	Deficit Financing	
	Brendshem	-6,258	-4,312	-6,416	-7,926	-7,449	-10,445	-9,389	-8,926	-11,620	-10,826	-6,818	28,750	Domestic	
	Te ardhura nga privatizimi	0	8	30	38	42	44	55	65	13,137	13,147	13,229	13,246	Privatization receipts	
	Hua-marje e brendeshme	2,017	4,610	2,840	6,495	2,972	3,436	10,717	11,733	6,450	8,721	11,753	17,039	Domestic Borrowing	
	Te tjera	-8,275	-8,930	-9,286	-14,459	-10,463	-13,925	-20,161	-20,724	-31,207	-32,694	-31,800	-1,535	Other	
	I Huaj	-272	-371	15	564	711	295	449	908	1,414	1,800	2,108	5,289	Foreign	
	Hua afatgjate(e marre)	99	230	840	1,400	1,854	1,950	2,301	3,936	4,234	4,818	5,670	9,109	Long-term Loan(Drawings)	
	Ndryshimi i gjendjes se arkës*	6	-6	-90	99	143	447	467	-495	-158	-78	-376	279	Chang. of stat. Account*	
	Ripagesat	-377	-595	-735	-936	-1,286	-2,102	-2,319	-2,533	-2,663	-2,940	-3,186	-4,098	Repayments	
	KAPITUTJ KRYESORE													Main indicators	
	Financimi i Brendshem i Defiçitit	-6,258	-4,312	-6,416	-7,926	-7,449	-10,445	-9,389	-8,926	-11,620	-10,826	-6,818	28,750	Domestically financed deficit	
	Defiçiti Pergjithshem	6,529	4,682	6,401	7,362	6,738	10,150	8,940	8,018	10,205	9,027	4,710	-34,040	Overall Balance	
	Te ardh. -Shpen. nga Sig. Shoq. dhe Shend.	-1,348	-3,636	-6,086	-8,107	-10,690	-13,337	-15,479	-18,489	-21,316	-23,003	-25,123	-28,094	Soc. & health insur. contr.-outlays	

* "Ndryshimi i gjendjes se arkës" perfaqeson ndryshimin ne Depozitet se Financimeve te Huaja

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

Tab - 5 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2007
Expenditures by central institutions during the year 2007

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Ministria ose Institucioni	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	Tetor Oct	Nentor Nov	Dhjetor Dec	Ministry or Institution
Totali	12,254	30,893	48,925	67,450	86,498	105,385	125,925	148,358	171,725	196,430	222,253	285,674	Total
Presidenca	6	14	23	40	42	52	64	76	85	99	112	127	President
Kuvendi	62	123	188	247	317	388	480	535	592	662	752	939	Parliament
Keshilli i Ministrave	26	69	127	376	400	432	565	600	661	721	824	1,046	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	38	122	190	532	655	751	873	3,453	4,776	6,125	6,207	7,439	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	65	298	555	755	1,214	1,501	1,922	2,179	2,541	3,052	3,513	4,509	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	169	3,801	5,092	6,247	7,715	9,347	11,483	14,205	17,519	21,726	26,133	41,520	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Sistemi i regjistrimit te pasurise se paluajtshme	13	33	62	91	119	145	178	208	244	273	316	422	Immovable Property Registration
Ministria e Financave	21	74	101	137	175	217	246	279	326	405	451	554	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	1,423	3,088	4,979	6,994	9,114	11,111	13,485	15,513	18,195	20,441	23,214	29,601	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	47	157	260	375	484	614	742	849	978	1,157	1,333	1,774	Ministry of Turisem, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	865	2,377	3,988	5,672	7,274	8,852	10,655	12,173	14,237	16,265	18,609	23,895	Ministry of Health
Ministria e Drejtësisë	97	270	462	641	847	1,038	1,208	1,407	1,655	1,965	2,249	2,787	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	68	254	346	525	658	784	919	1,045	1,216	1,295	1,455	1,577	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	698	1,411	2,336	3,278	4,200	5,226	6,294	7,205	8,391	9,684	10,915	13,023	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	527	1,552	3,123	4,078	5,034	5,979	6,836	7,704	8,940	10,083	11,956	16,672	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ I Shtetit	57	125	197	284	382	441	525	603	706	839	930	1,056	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	24	49	74	96	133	164	191	215	248	288	324	375	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	3	10	25	34	43	51	57	64	79	94	107	179	General Directorate of Archive
Drejtoria e Rezerves se Shtetit	5	11	19	27	34	43	50	56	64	71	83	98	Directorate of State Reserves
Akademia e Shkencave	29	64	103	149	189	223	270	312	345	375	428	523	Science Academy
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	6	20	38	58	82	102	120	135	156	175	193	228	State Audit Commission
Ministria e Punes, Ceshetje Sociale dhe Shanseve te barabarta**	4,694	10,213	15,776	21,541	27,371	33,419	39,428	45,819	52,169	58,235	64,048	74,987	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrove	40	105	180	283	378	501	589	728	845	977	1,109	1,389	Ministry of Environment, Foristry & Water Administration
Agjensia Kombetare e Privatizimit													National Agency for Privatization
